



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 11 dhjetor 2020

Nr. i lëndës: 2019-01

G.T.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 11 dhjetor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Kjo ankesa është regjistruar më 1 gusht 2019.
2. Ankuesja ka kërkuar që identiteti i saj mos të bëhet publik. Duke shqyrtuar çështjen, posaçërisht rrethanat e lëndës, Paneli është i bindur që kjo kërkesë duhet të pranohet.
3. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli informoi EULEX-in Kosovë ("Misioni") se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
4. Më 16 tetor 2019, Paneli kërkoi nga ankuesja të siguronte informata shtesë në lidhje me ankesën.
5. Më 29 tetor 2019, ankuesja paraqiti informata shtesë.

6. Më 26 nëntor 2019, Paneli i dërgoi Misionit një Deklaratë të Pretendimeve dhe Pyetjeve, duke kërkuar nga Misioni përgjigje me shkrim dhe vërejtje rreth ankesës jo më vonë se deri më datën 26 janar 2020.
7. Paneli pranoi vërejtjet e shefit të Misionit më 18 shkurt 2020.
8. Më letrën e datës 19 shkurt 2020, ankuesja u ftua të përgjigjej në parashtresat e Misionit nëse ajo do të dëshironte ta bënte këtë.
9. Ankuesja paraqiti vërejtjet e saj rreth parashtresave të Misionit më 12 mars 2020.
10. Më 4 qershor 2020, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 3 (ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe 8 (e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, vendbanimin dhe korrespondencën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2020-06-04%20Admissionability%20Decision%202019-01%20signed.pdf>).
11. Më 3 gusht 2020, Paneli pranoi parashtresat e ankuesit rreth meritave.
12. Më 7 gusht 2020, Paneli i transmetoi këto Misionit për informacion.
13. Më 1 tetor 2020, Paneli pranoi parashtresat e Misionit rreth meritave.
14. Më 28 tetor 2020, Paneli i transmetoi këto tek ankuesja për informacion.

II. FAKTET

15. Faktet e lëndës, siç paraqiten nga palët dhe siç duket nga dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
16. Ankuesja mori një thirrje nga një gjykatë në Kosovë për t'u paraqitur si dëshmitare në një seancë penale që po zhvillohej diku në vitin 2019 në një gjykatë në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejme "Serbia"). Këto procedura penale kishin të bënin me krime të rënda që dyshohej se ishin kryer gjatë konfliktit në Kosovë në vitet 1998-99. Ankuesja më parë kishte dhënë deklarata të dëshmitares, përfshirë edhe në Mision, në lidhje me të njëjtat ngjarje.
17. Pak kohë pasi ankuesja kishte pranuar thirrjen dhe para datës së caktuar të seancës dëgjimore, Misioni kontaktoi ankuesen në lidhje me thirrjen dhe udhëtimin nga vendbanimi i saj në Kosovë për në Serbi për të dëshmuar në seancë.
18. Misioni më pas organizoi transportin dhe shoqëroi ankuesen në Serbi diku në vitin 2019.
19. Misioni gjithashtu përzgjedhi akomodim tjetër në Serbi për ankuesen kur u gjet se akomodimi i ofruar nga autoritetet serbe ishte i papërshtatshëm. Misioni kishte sjellë së bashku një mjek shqipfolës, pasi këto masa paraprake i kishte parë të nevojshme.
20. Sipas ankueses, ajo ishte kërcënuar dhe frikësuar përderisa ishte në Serbi dhe më pas edhe në shtëpinë e familjes së saj në Kosovë, si rezultat i dëshmisë së saj në Serbi. Ankuesja vuan nga trauma si rezultat i këtij frikësimi. Hollësitë se çfarë përbëjnë këto kërcënime dhe veprimet e frikësimit përshkruhen më poshtë.

III. ANKESAT

21. Ankuesja pretendon se Misioni premtoi se do ta mbronte atë, por nuk ka arritur ta bëjë këtë. Ajo u frikësua në gjykatën në Serbi dhe mori kërcënime anonime përderisa ishte në shtëpi në Kosovë.
22. Ankuesja pretendon se Misioni ka shkelur të drejtat e saj të njeriut duke e ekspozuar atë ndaj këtij kërcënimi dhe duke mos marrë masa të duhura për ta mbrojtur atë nga këto. Ankuesja pretendon se ky kërcënim i ka shkaktuar asaj stres dhe traumë. Ajo pretendon se shëndeti dhe mirëqenia e saj mendore janë prekur rëndë nga kjo përvojë dhe po merr kujdes mjekësor për shkak të kësaj.
23. Ankuesja pretendon shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"), pa specifikuar ndonjë nen të veçantë të Konventës. Paneli vëren se, në përputhje me praktikën gjyqësore të vendosur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gjykata"), një ankesë karakterizohet nga faktet, dhe është roli i Gjykatës - ose, në rastin konkret, i Panelit - për të karakterizuar ligjin siç aplikohet për faktet (parimi i *jura novit curia*, shih p.sh. *Şifeerife Yiğit kundër Turqisë* [GC], nr. 3976/05, 2 nëntor 2010, par. 52). Paneli konsideron se pretendimet faktike të paraqitura nga ankuesja kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të garantuara në nenet e mëposhtme të Konventës: Neni 3 (ndalimi i torturës, dënimit ose trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës) dhe neni 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, vendbanimit dhe korrespondencës). Mbi atë bazë ankesa u shpall e pranueshme.

IV. PARASHTRIMET E PALËVE

Ankuesja

24. Paneli i përsërit këtu parashtrimet fillestare të ankueses, pasi këto, së bashku me përgjigjet e ankueses të përshkruara më poshtë, janë materiale për vlerësimin e Panelit rreth meritave.

Parashtrimet fillestare

25. Në parashtrimet fillestare, ankuesja pohon se kur Misioni kishte kontaktuar me të, zyrtarët e Misionit "na thanë [ankueses dhe dëshmitarëve të tjerë] të shkonim në një Gjykatë për të ofruar deklaratat për një rast të [e redaktuar nga Paneli]. EULEX-i premtoi shumë siguri, por ajo që ndodhi ishte e kundërta". Ankuesja pretendon se Misioni premtoi të garantojë sigurinë e saj gjatë udhëtimit në Serbi. Nga parashtrirat e ankueses është e qartë se ajo kishte kuptuar që Misioni do të ishte përgjegjës për sigurinë e saj.
26. Ankuesja pretendon se kishte pranuar të shkonte dhe dëshmonte vetëm për shkak të garancisë rreth sigurisë nga ana e Misionit. Duke iu përgjigjur vërejtjes së Misionit se e kishte njoftuar ankuesen se autoritetet serbe do të ishin përgjegjës për sigurinë, ankuesja deklaroi se nëse ajo do ta kishte ditur që autoritetet serbe do të ishin përgjegjës për sigurinë e saj, ajo nuk do të pranonte të udhëtonte në gjykatë në Serbi, pasi ajo nuk u beson autoriteteve serbe.
27. Sa i përket frikësimit të saj të supozuar, ankuesja pretendon se ajo ishte kërcënuar dy herë me pasoja për familjen e saj përderisa po jepte deklaratën e dëshmitarit në gjykatë në Serbi. Në një moment kur ishte në gjykatë, ankuesja pretendon se persona të paidentifikuar nxituan drejt saj dhe dëshmitarëve të tjerë, duke folur në gjuhën serbe që ajo nuk mund t'i kuptonte.

28. Ajo pretendon se zyrtarët e Misionit ishin dëshmitarë të ngjarjeve, por nuk reagojnë. Ankuesja pretendon se, si rezultat i këtij frikësimi, ajo kërkoi kujdes mjekësor gjatë procesit për të përballuar stresin.
29. Pas kthimit të saj në Kosovë, ankuesja pretendon se ka marrë telefonata anonime dhe është shqetësuar në orët e vona kur ishte në shtëpinë e saj. Ajo jeton në shtëpinë e saj me anëtarët e familjes. Ankuesja pretendon se ajo e raportoi rastin në Policinë e Kosovës. Ajo ka vazhduar të kërkojë kujdes mjekësor dhe i ka dorëzuar në Panel dëshmitë e një diagnozë mjekësore të çrregullimit të stresit pas traumatik dhe trajtimit si rezultat.

Përgjigjet ndaj pyetjeve të Panelit

30. Në pyetjen e Panelit nëse ajo ka vazhduar të marrë kërcënime dhe telefonata anonime që nga ngjarjet e përshkruara në ankesën fillestare, ankuesja u përgjigj se megjithëse lëvizjet e saj ishin kufizuar nga pandemia e koronavirusit, kur ajo del jashtë "vazhdimisht është ngacmuar nga persona të panjohur". Ajo deklaroi se i ka kërkuar policisë së Kosovës që t'i ofroj asaj siguri. Sidoqoftë, sipas ankueses, policia ka refuzuar pasi ata deklarojnë se nuk mund të hapin rast pa i njohur personat. Ankuesja deklaroi se policia i ka kërkuar asaj që t'i fotografojë personat që e ngacmojnë, por ajo pretendon se "nuk mund t'i fotografonte, sepse [ajo] ishte kërcënuar prej tyre në vende publike, me zë të ulët, dhe pastaj ata janë larguar në drejtim të panjohura".
31. Në pyetjen e Panelit nëse ajo ka raportuar kërcënimet ndaj Misionit, ankuesja u përgjigj se ajo i ka raportuar këto në Mision, "dhe gjithçka është depozituar me shkrim, ku [ajo] ka specifikuar format e kërcënimit".
32. Sa i përket pyetjes së Panelit se çfarë i tha Misioni kur ajo raportoi kërcënimet ndaj Misionit, ankuesja deklaroi se
- "[Misioni] madje nuk i ka marrë parasysh ankesat e mia, kërcënimet ndaj [saj] që ndodhën pasi [ajo] ishte kthyer në Kosovë. E as nuk i morën parasysh kërcënimet që ndodhën në gjykatë në [Serbi], ndërsa injoruan [atë, dhe duket se ankuesja po iu referohet edhe dëshmitarëve të tjerë në seancë] që [ajo dhe dëshmitarët e tjerë] pretendohet se nuk ishin duke thënë të vërtetën dhe [ajo] tha që nga fillimi se nëse [ajo] do ta dinte që [asaj dhe dëshmitarëve të tjerë] nuk do t'u ofrohej siguri nga [Misioni], [ajo] nuk do të kishte udhëtuar për të dëshmuar qoftë edhe për faktin që drejtësia të vihej në vend për viktimat e pafajshme të krimeve serbe".
33. Në pyetjen e Panelit se kur dhe si i raportoi kërcënimet dhe telefonatat anonime në policinë e Kosovës, ankuesja deklaroi se ajo i raportoi këto në polici menjëherë pasi që ndodhnin. Ajo deklaroi se kishte dhënë një deklaratë në polici, duke shprehur se ata do t'i ofronin asaj siguri. Panelit nuk iu është ofruar ndonjë e dhënë e tillë.
34. Paneli më tej kishte kërkuar që ankuesja të ofronte ndonjë dëshmi të thirrjeve anonime, raportet në polici dhe çfarëdo hapi të ndërmarrë nga policia. Ankuesja nuk ofroi ndonjë provë të tillë dhe nuk e adresoi në mënyrë të qartë çështjen e provave në parashtrësit e saj. Prandaj, Paneli u është drejtuar disa prej parashtrësive të bëra me kujdes kur informacioni vërtetues nuk ishte ofruar, megjithëse shumë lehtë do të kishte qenë në dispozicion të ankueses.
35. Paneli i kishte kërkuar ankueses për të përshkruar pasojat që kanosja dhe çrregullimi i stresit pas traumatik kanë pasur mbi të dhe familjen e saj. Ankuesja u përgjigj se ajo, si kryefamiljare e familjes, ka qenë "jashtëzakonisht e shqetësuar dhe e frikësuar se diçka e keqe mund të ndodhë [e redaktuar; referenca për anëtarët e ngushtë të familjes së

ankueses që jetojnë në Kosovë dhe jashtë saj]]. Një referencë në lidhje me mbrojtjen e policisë në këto pjesë të parashtrësive është e paqartë.

36. Ankuesja në parashtrësive e saj ofroj raporte të mëtejshme mjekësore në lidhje me kushtet e saj mjekësore. Në parashtrësive e saj fillestare, ankuesja kishte siguruar prova mjekësore të një diagnoze të sindromës së stresit pas traumatik pas dëshmisë së saj të dëshmitarit në Serbi.

Misioni

37. Rreth pyetjeve të Panelit, të përsëritur në Vendimin e tij të Pranueshmërisë, duke kërkuar nga Misioni të sigurojë hollësi rreth rolit dhe përgjegjësisë të tij në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe duke kërkuar një shpjegim se si është i angazhuar roli i mbrojtjes së dëshmitarëve të Misionit, nga kush, ose nga cilat autoritete, Misioni përsëriti se ankuesja “nuk është dhe kurrë nuk ka qenë në Programin e EULEX-it Kosovë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”. Misioni vuri në dukje se ankuesja nuk është dëshmitare e mbrojtur në procedurat penale në Serbi dhe se kopja e dëshmisë së saj është në dispozicion të publikut, duke zbuluar emrin e saj. Misioni më tej vuri në dukje në lidhje me këto dy pyetje se “EULEX-i Kosovë ofron siguri për dëshmitarët e mbrojtur në përputhje me dispozitat ekzistuese ligjore të Kosovës (Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve Nr. 04/L-015, dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës)” (theksohet në origjinal). Misioni nuk dha hollësi të mëtejshme mbi rolin dhe përgjegjësitë e tij në mbrojtjen e dëshmitarëve.
38. Paneli ka pasur mundësinë të shqyrtoj transkriptin e lartpërmendur.
39. Në Vendimin e tij për Pranueshmëri, Paneli gjithashtu përsëriti pyetjen e tij të mëparshme, duke kërkuar që Misioni të shpjegojë bazën ligjore për Misionin që të kryej aktivitete për mbrojtjen e dëshmitarëve në territorin e Serbisë jashtë kufijve të Kosovës dhe/ose në emër të gjykatave operative nën autoritetin e Serbisë gjithashtu duke kërkuar një shpjegim gjithëpërfshirës të bazës ligjore në këtë rast të veçantë që Misioni të shoqërojë ankuesen në Serbi për të siguruar dëshminë e dëshmitarit. Në parashtrimet e tij, Misioni deklaroi se “nuk kreu 'veprime për mbrojtjen e dëshmitarëve' në territorin e Serbisë jashtë kufijve të Kosovës”; përkundrazi, “thjesht e ndihmoi” ankuesen “në udhëtimin në [Serbi] në mënyrë që të dëshmonte në seancë në cilësinë e dëshmitares”.
40. Misioni më tej shpjegoi se gjatë mandatit të tij ekzekutiv në sistemin e drejtësisë penale, ai nuk mund të zhvillonte procedura në shumë raste të pretenduara të krimeve të luftës pasi që të dyshuarit dhe mbrojtësit nuk ishin në dispozicion. Prandaj Misioni bashkëpunoi me autoritetet serbe në një numër rastesh që ndiqen penalisht në Serbi, të tilla si në këtë rast, për të siguruar përgjegjësi për krimet më të rënda sipas ligjit ndërkombëtar. Misioni i referohet një interviste të ankueses si dëshmitare e realizuar nga Misioni në prill 2010, dhe deklaroi se dosja e lëndës që përmbante deklaratën e dëshmitares iu dorëzua institucioneve të Kosovës më 20 dhjetor 2018 në fazën e hetimit paraprak duke rekomanduar që të verifikohet statusi i procedurave në Serbi.
41. Në pyetjen e Panelit se cilat organe të Misionit ishin përgjegjëse për sigurinë e ankuesit ndërsa ishin në Kosovë, Misioni nuk dha ndonjë përgjigje.
42. Në pyetjen e Panelit se cila pjesë e Misionit e shoqëronte ankuesen në Serbi dhe kujt i raportuan, Misioni përsëriti që stafi i Misionit nga Shtylla e Operacioneve kishte vizituar ankuesen për ta informuar atë se Misioni do të ishte në gjendje ta dërgonte atë në Serbi, nëse ajo do të jetë e gatshme të respektojë thirrjen gjyqësore. Misioni nuk ofroi ndonjë përgjigje të hollësishme se cilës pjesë të Misionit i përkisnin zyrtarët që shoqëronin ankuesen dhe kujt i raportonin.

43. Në pyetjen e Panelit se çfarë i komunikoi ankueses Misioni në lidhje me atë se cilat organe të Misionit ishin përgjegjëse për sigurinë e saj ndërsa ishte në Kosovë dhe nga cila pjesë e Misionit do të ishin zyrtarët që e shoqëronin atë, Misioni deklaroi se zyrtarët e saj i shpjeguan ankueses se,

“Pjesëmarrja e saj në seancë ishte plotësisht vullnetare; se për të mund të ishte shqetësuese që të jepte dëshmi në prani të mbrojtësve, por që Misioni nuk luan asnjë rol në procedurat penale dhe autoritetet serbe janë përgjegjëse të vetëm gjatë gjithë kohës gjatë udhëtimit të saj jashtë kufijve të Kosovës. Misioni gjithashtu shpjegoi se pranimi i saj i mbështetjes së EULEX-it Kosovë nuk do t'i jepte të drejtë për ndonjë asistencë të mëtejshme më pas”.

44. Misioni iu referua një kërkesë të bërë nga ankuesja për asistencë në marrjen e vizës për disa nga të afërmit e saj të ngushtë në një vend të tretë, dhe deklaroi se ia shpjegoi ankueses se nuk mund t'ia plotësonte kërkesën. Misioni vëren se ankuesja pastaj deklaroi se ishte e gatshme të dëshmonte në Serbi dhe pranoi "ofertën e mbështetjes" së Misionit.
45. Misioni deklaroi se asnjë nga bisedat me ankuesen nuk ishte regjistruar, por që stafit përkatës të Misionit "i kujtohen qartë ngjarjet, veçanërisht duke pasur parasysh që veprimet e ndërmarra ishin për një person jashtë Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve”.
46. Paneli pyeti Misionin se cili organ (nëse jo Misioni) ishte përgjegjës për sigurinë e ankueses përderisa ishte në Kosovë, duke kërkuar prova të marrëveshjes përkatëse ndërmjet Misionit dhe organit tjetër mbi rregullimet dhe përgjegjësitë përkatëse. Misioni nuk dha ndonjë përgjigje për këtë pyetje.
47. Në pyetjen e Panelit nëse Misioni kishte kryer vlerësimin e rrezikut, përfshirë nevojën për masa mbrojtëse, në lidhje me sigurinë e ankueses, Misioni u përgjigj se nuk e bëri një vlerësim të tillë. Misioni shprehet se

“kjo nuk ishte kërkuar duke pasur parasysh që roli i tij ishte thjeshtë të lehtësonte pjesëmarrjen e [ankueses] në seancën gjyqësore në [Serbi]. Sidoqoftë, siç është treguar tashmë, ai mori të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar mirëqenien e saj gjatë udhëtimit [në Serbi]”.

48. Rreth pyetjes së Panelit mbi llojin e masave mbrojtëse që Misioni mendon se do të jenë në dispozicion për një dëshmitar që frikësohet për shkak të dëshmisë së tyre dhe për rolin e Misionit në vlerësimin e domosdoshmërisë së masave të tilla dhe në zbatimin e tyre, Misioni bëri një referencë në legjislacionin e Kosovës (*Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve Nr. 04/L-015*), por nuk dha hollësi të mëtejshme.
49. Misioni nuk pranoi t'i sigurojë Panelit qasje në komunikimet ndërmjet Misionit dhe autoriteteve serbe për bashkërendimin, ndarjen e përgjegjësive dhe rregullimet praktike, posaçërisht të sigurisë, në lidhje me udhëtimin dhe dëshminë e ankuesit në Serbi.
50. Misioni gjithashtu nuk pranoi t'i sigurojë qasje Panelit në kërkesën nga autoritetet serbe që Misioni e kishte referuar në parashtrimet e tij fillestare. Misioni refuzoi qasjen me arsyetimin se komunikimi përfshin Misionin dhe një palë të tretë.
51. Paneli i kërkoi Misionit të specifikojë bazën për kërkesën nga autoritetet serbe për ndihmën e Misionit, përkatësisht nëse *Korniza e Politikave të BE-së për Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale (2015)* ishte kjo bazë dhe nëse Misioni iu bëri autoriteteve serbe dhe ankueses me dije se Misioni po ndihmonte mbi atë bazë. Misioni në përgjigjen e tij

përsërit se i dha ndihmë ankueses “në kontekstin e [Kornizës së lartpërmendur të Politikës]”. Misioni përsëri deklaroi se i kishte shpjeguar ankueses se Misioni nuk ishte i përfshirë në procedurat në Serbi dhe se autoritetet serbe ishin ekskluzivisht të ngarkuara me sigurinë e saj gjatë qëndrimit të saj në Serbi. Misioni thekson më tej se

“duke ia shpjeguar këtë ankueses, Misioni nuk e konsideroi të nevojshme të bënte dallimin midis një personi të regjistruar në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe një dëshmitari jashtë Programit. [Ankuesja] dukej se e kuptonte zotimin e dhënë nga Misioni dhe vullnetarisht ishte pajtuar të udhëtonte”.

Misioni nuk dha një përgjigje në pyetjen rreth dijenisë prej autoriteteve serbe në lidhje me bazën e ndihmës së Misionit.

52. Paneli i kërkoi Misionit të shpjegojë procedurën e ndihmës juridike të ndërsjellë, të referuar në parashtrësit e Misionit mbi pranueshmërinë dhe të sqarojë rolet përkatëse të (a) Misionit; (b) zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë; (c) autoriteteve të Kosovës; dhe (d) autoriteteve të Serbisë, veçanërisht në lidhje me ndihmën dhe sigurinë për dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar jashtë kufijve. Misioni në parashtrësit e tij thekson se ai nuk luan asnjë rol në procedurën e ndihmës juridike të ndërsjellë dhe se është roli i Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë për të ndihmuar me kërkesat dhe përgjigjet e ndihmës juridike ndërkombëtare, bazuar në Procedurën 2015 për Ligjin e Ndërsjellë Ndihma midis Beogradit dhe Prishtinës që rrjedh nga "Dialogu i Brukselit".
53. Rreth pyetjes së Panelit mbi ndryshimet ligjore dhe praktike në lidhje me sigurinë dhe ndihmën për dëshmitarët në aktivitetet e Misionit nën *Kornizën e Politikave të BE-së për Mbështetjen në Drejtësinë Tranzicionale (2015)* dhe Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Misioni nuk ofroi ndonjë përgjigje.
54. Rreth pyetjes së Panelit nëse zyrtarët e Misionit e inkurajuan ose i kërkuan ankueses që të dëshmonte në gjykimin penal dhe duke kërkuar që Misioni të sigurojë një kopje të çdo komunikimi me shkrim ndërmjet Misionit dhe ankueses, Misioni u përgjigj se zyrtarët e tij nuk e kanë nxitur apo kërkuar që ankuesja të dëshmojë. Në vend të kësaj, parashtron Misioni, zyrtarët thjesht e informuan ankuesen se në rast se ajo vendoste të paraqitej në gjykatë, Misioni mund të ndihmonte për udhëtim. Misioni nuk ofroi ndonjë kopje të ndonjë komunikimi me shkrim dhe nuk e adresoi këtë pjesë të pyetjes.
55. Në pyetjen e Panelit nëse zyrtarët e Misionit të pranishëm në gjykatë në Serbi diskutuan ngjarjet dhe pretendimet rreth kërcënimeve në gjykatë me ankuesen, Misioni u përgjigj se tashmë i ishte përgjigjur kësaj pyetjeje dhe nuk kishte asgjë tjetër për të shtuar.
56. Misioni nuk ka dhënë ndonjë përgjigje në kërkesën e Panelit për sqarim nëse në hetimet e tij me policinë e Kosovës, të përmendura në parashtrësit fillestare të Misionit, Misioni kishte verifikuar të dhënat telefonike të ankueses për të konstatuar nëse ankuesja kishte marrë telefonatë anonime apo nëse i kishte kërkuar ndonjë pale të tretë të kryejë ndonjë verifikim të tillë.
57. Misioni gjithashtu nuk ofroi ndonjë përgjigje në kërkesën e Panelit për sqarim nëse, gjatë pranisë së tyre në Serbi, stafi i Misionit që shoqëronte ankuesen iu ishte nënshtruar autoritetit dhe udhëzimeve të autoriteteve serbe.
58. Misioni në parashtrësit e tij ofron një numër vërejtjesh mbi parashtrësit e ankueses. Misioni vëren se konstaton që ankuesja nuk arrin të sigurojë hollësitë e kërcënimeve dhe telefonatave anonime që pretendohet se po merr ose ka marrë në të kaluarën. Misioni thekson se do të priste që ankuesja të ishte në gjendje të siguronte të paktën disa hollësi.

59. Misioni më tej deklaroi, siç duket duke kundërshtuar pretendimin e ankueses se ajo ka raportuar kërcënimet ndaj Misionit, se nuk ka marrë ndonjë komunikim me shkrim nga ankuesja pas parashtrimit të letrës së ankueses tek Misioni me datën 28.06.2019, të cilën Misioni më pas ia kishte dërguar Panelit.
60. Misioni pretendon se, sipas tij, kërcënimet që ankuesja pretendon se i ka marrë në gjykatën në Serbi në lidhje me atë që ajo nuk po thoshte të vërtetën do të ishte në të vërtetë paralajmërim nga kryetari i trupit gjykues që, si dëshmitare, ajo ishte nën detyrim për të thënë të vërtetën. Çështja e detyrimit për të thënë të vërtetën u ngrit disa herë gjatë seancës, siç është e qartë në procesverbalin e seancës, të cilën Paneli ka pasur mundësinë të shqyrtojë.
61. Misioni gjithashtu thekson që megjithëse pendohet që ankuesja vuan nga probleme shëndetësore, nuk mund të gjejë ndonjë lidhje midis problemeve shëndetësore dhe veprimeve të Misionit.
62. Në lidhje me meritat e ankesës, Misioni u referohet parashtrësve të tij fillestare dhe thotë se e konsideron ankesën që nuk ka merita. Misioni thekson që ankuesja "*nuk ka arritur të bëjë ndonjë pretendim të argumentueshëm kundër EULEX-it sipas nenit 3 të Konventës, si në lidhje me ngjarjet [në gjykatën në Serbi] dhe gjithashtu në lidhje me ngjarjet në Kosovë. Dokumentacioni mjekësor i siguruar nga [ankuesja], disa prej të cilave është i paqartë, nuk dëshmon në asnjë mënyrë që diçka nga gjendja e saj shëndetësore t'i atribuohet EULEX-it*" (theksi në origjinal).
63. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 8 të Konventës, Misioni "përsërit se nuk kishte asnjë ndërhyrje në gëzimin e të drejtave të [ankueses] sipas nenit 8 të Konventës, pasi që [ankuesja] pranoi ndihmën e Misionit *vullnetarisht* dhe falënderoi stafin e saj për mbështetjen më pas" (theksi në origjinal).
64. Paneli ka pasur mundësinë të shikojë një dokument konfidencial në dosjet e Misionit, i cili ka të bëjë me deklaratën paraprake të ankueses në lidhje me gatishmërinë e saj për të dëshmuar në Serbi. Paneli merr shënime nga ai dokument, megjithëse nuk mund të zbulojë përmbajtjen në vendimin e tij.

V. SHQYRTIMET

65. Në Vendimin e tij për Pranueshmëri në çështjen në fjalë, Paneli vërejti se "dëshmia e dëshmitarit është shpesh thelbësore për ndjekjen penale të autorëve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Për të inkurajuar dëshmitarët të japin dëshmi, është thelbësore që autoritetet të marrin masa adekuate për mbrojtjen e tyre (shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, 10 prill 2013, paragrafi 47; Rekomandimi Rec (2005) 9 i Komitetit të Ministrave, Këshilli i Evropës, dhe paragrafët 1 dhe 2 në veçanti, Rekomandimi i referuar gjithashtu në Aktgjykimin e Gjykatës R.R. *dhe të tjerët kundër Hungarisë*, 4 dhjetor 2012, paragrafi 32; neni 13 i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, në lidhje me dëshmitarët e torturave të pretenduara, neni 12(1) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, në lidhje me dëshmitarët në rastet e zhdukjes, neni 18 i Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 Tetorit 2012 që vendos standardet minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit; Rezoluta 60/147 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të 16 dhjetorit 2005, paragrafi 12 (b)) "(shih *G.T. kundër EULEX-it*, 2019-01, 4 qershor 2020, paragrafi 36).

66. Për më tepër, në një çështje të mëparshme që përfshinte procedura penale në Serbi, Paneli vërejti se "është detyrë normale qytetare që individët japin dëshmi në procedurat penale (*Voskuil k. Holandës* nr. 64752/01, Aktgjykimi i GJEDNJ i 22 nëntorit 2007, par. 86) "(shih *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, 10 prill 2013, par. 47). Në të njëjtën lëndë, Paneli më tej iu referua "interesit të fortë të bashkësisë ndërkombëtare në zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të rëndë, në veçanti të krimeve të luftës", por vuri në dukje se përgjegjësia për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime të rënda përfshinë gjithashtu përgjegjësi mbi pjesë të autoriteteve kompetente për të mbrojtur ata që u japin atyre informacion, d.m.th. dëshmitarët" (*ibid.*). Përgjegjësia për të mbrojtur dëshmitarët mund të nënkuptojë detyrim pozitiv nga ana e autoriteteve për të marrë masa për të garantuar sigurinë dhe sigurinë e dëshmitarëve, megjithëse ky detyrim nuk duhet të vendosë mbi ta një barrë të pamundur ose disproporcionale (shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, paragrafi. 48; *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 7678/09, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i datës 13 nëntor 2012, par. 88, mbi detyrimin për të marrë masa parandaluese).
67. Misioni, në bazë të mandatit të tij, është i vetëdijshëm për rreziqet e sigurisë për dëshmitarët në procedurat e krimeve të luftës. Në këtë rast të veçantë, Misioni do të kishte qenë në dijeni të natyrës serioze të krimeve të pretenduara që ndiqen penalisht në gjykatë në Serbi, dhe faktin që ankuesja nuk ishte vetëm një dëshmitare, por edhe viktimë e të njëjtave ngjarje themelore. Paneli konkludon se duke propozuar që të shoqërojë ankuesen në Serbi, duke ndërmarrë hapa drejt sigurimit të mirëqenies së saj, duke bashkërenduar dukshëm analizimin e sigurisë me autoritetet e Serbisë dhe duke diskutuar çështjen e sigurisë me ankuesen, Misioni pa dyshim pranoi që kishte rreziqe për sigurinë dhe mirëqenien e saj. Gjatë adresimit të atyre çështjeve me ankuesen, Misioni krijoi përshtypjen se ishte kompetent për ta bërë këtë dhe, të paktën në kuptimin e ankueses, do të ishte përgjegjës për këto.
68. Misioni ka përsëritur pretendimin e tij se ankuesja nuk hyn në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve të Misionit. Paneli shpreh keqardhje që Misioni përsëri zgjodhi të mos u përgjigjej pyetjeve të Panelit në lidhje me Programin e tij të Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Misioni gjithashtu nuk dha ndonjë përgjigje mbi ndryshimet ligjore dhe praktike midis Programit dhe aktiviteteve të tij nën *Kornizën e Politikave të BE-së për Mbështetjen në Drejtësinë Tranzicionale (2015)*. Sidoqoftë, Misioni deklaroi se nuk i shpjegoi ankueses dallimin midis aktiviteteve të tij sipas Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe aktiviteteve të tij në lidhje me ankuesen. Kuadri ligjor mbi të cilin ka vepruar Misioni është dhe mbetet, plotësisht i paqartë dhe i pasigurt. Kjo pashmangshëm duhet të ketë qenë situata edhe për ankuesen, e cila nuk është e trajnuar në aspektin ligjor dhe nuk do të ishte në gjendje të nxjerrë ndonjë konkluzion kuptimplotë nga baza ligjore mbi të cilën Misioni pretendonte të vepronte.
69. Paneli vëren se nga informacionet në dispozicion të tij se është e qartë që ankuesja besonte se Misioni ishte përgjegjës për sigurinë e saj. Ndërsa Paneli pranon që ankuesja mund të mos ketë qenë dëshmitare e mbrojtur në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve të Misionit, Misioni mund të mos kërkojë të përjashtojë përgjegjësinë e tij për të mbrojtur ndonjë dëshmitar kur ai angazhohet në aktivitete të këtij lloji në rastin në fjalë, duke iu referuar fushëveprimet të kufizuar të Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve, veçanërisht kur e pranon vet, Misioni nuk ia bëri ankueses të qartë dallimin.
70. Për më tepër, Paneli përsërit se korniza ligjore e Misionit nuk parashikon dhe as nuk autorizon Misionin për të siguruar asistencë dhe mbështetje për dëshmitarët në lëndë penale jashtë mandatit të tij ekzekutiv dhe sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve të bashkangjitur në të. Dështimi i Misionit për të adresuar plotësisht çështjen dhe për të sqaruar bazën ligjore mbi të cilën ai operon përbën, të paktën, një tregues të pranisë së

diskutueshme të një baze të vlefshme ligjore për ata që kanë të bëjnë më së drejtpërdrejt me të.

71. Misioni nuk iu përgjigj pyetjes së Panelit se cili organ, nëse jo Misioni, ishte përgjegjës për sigurinë e ankueses brenda Kosovës. Paneli gjithashtu shpreh keqardhje që Misioni refuzoi qasjen për Panelin për të parë komunikimet përkatëse në lidhje me sigurinë dhe aranzhimet e tjera në lidhje me dëshmitaren. Këto dështime - dhe të tjerët të përmendur më lart – nxisin Panelin që të nxjerrë konkluzione të caktuara nga dështimi i Misionit ose pamundësia për t'iu përgjigjur disa prej këtyre pyetjeve.
72. Bazuar në veprimet e Misionit, perceptimin që ai krijoi në mendjen e ankueses, mungesën e një baze të qartë ligjore që qëndron në themel të atyre veprimeve dhe dështimin e Misionit për të siguruar dokumentacionin dhe përgjigjet përkatëse në pyetjet e Panelit, Paneli duhet të konkludojë se Misioni ishte përgjegjës për sigurinë e ankueses brenda kufijve të Kosovës. Lidhur me situatën përderisa ishte në Serbi, Paneli e konsideron atë në vijim.
73. Lidhur me situatën në Serbi, Paneli pranon që autoritetet e Serbisë do të kishin pasur përgjegjësinë kryesore për sigurinë dhe mirëqenien e ankueses ndërsa ajo ishte në Serbi. Megjithëse kjo domosdoshmërisht do të kishte kufizuar aftësinë e Misionit për të vepruar në lidhje me sigurinë e ankueses përderisa ishte në Serbi, kjo nuk i lë mënjanë përgjegjësitë e Misionit ndaj të drejtave të njeriut kur ai ndërmerr veprime të tilla si ato në rastin në fjalë.
74. Panelit i kujtohet fakti që Misioni dërgoi personelin e tij në Serbi për të shoqëruar ankuesen, që Misioni siguroi një mjek për të dhe se kur nuk ishte i kënaqur me aranzhimet e akomodimit, Misioni bëri alternativën e vet. Kjo do të kërkonte një shkallë bashkëpunimi dhe bashkërendimi me autoritetet serbe dhe planifikim të gjerë nga Misioni. Paneli shpreh keqardhje që Misioni nuk pranoi të sigurojë informacion mbi aranzhimet e tij të sigurisë me autoritetet serbe, dhe rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, në veçanti. Përsëri, ai dështim lidhet drejtpërdrejt me konkluzionet që do të nxirren nga Paneli duke marrë parasysh që Misioni i ka këto informacione në posedim dhe ka refuzuar ta ndajë me Panelin pa dhënë ndonjë arsye.
75. Paneli vëren se Misioni nuk ka ndërmarrë ndonjë vlerësim të rrezikut në lidhje me ankuesen. Misioni në parashtrirat e tij thekson se nuk konsideron se kërkohej ndonjë vlerësim i tillë në këtë rast. Paneli nuk pajtohet. Në këtë kontekst, Paneli vëren se Misioni do të kishte qenë në dijeni të mjedisit potencialisht të pasigurt për ankuesen, duke pasur parasysh natyrën e procedurave penale në Serbi dhe rreziqet për dëshmitarë në procedura të tilla në kontekstin e përgjithshëm pas konfliktit. Në masën që do të kishte dështuar të merrte në konsideratë mundësinë e ekzistimit të një rreziku të tillë, Misioni do të kishte qenë i pakujdesshëm në ushtrimin e përgjegjësive të tij. Misioni gjithashtu do të kishte qenë në dijeni të faktit që ankuesja ishte vetë viktimë e ngjarjeve që ishin subjekt i procedurave penale. Misioni gjithashtu do të kishte qenë i vetëdijshëm për seriozitetin e shkeljeve në lidhje me të cilat ajo po dëshmonte. Për më tepër, Misioni kishte në posedim të tij dokumentin konfidencial të përshkruar më lart dhe i cili është i rëndësishëm për shqyrtimin e Panelit këtu për sa i përket shprehjeve të shqetësimit të ankueses në lidhje me dëshminë në Serbi. Në fakt Misioni pranoi të paktën disa nga rreziqet që lidhen me një dëshmi të tillë duke dërguar sigurimin dhe mbështetje mjekësore për t'iu kujdesur për ankuesen.
76. Përkundër njohurive të tij për këto rrethana, Misioni nuk ka kryer ndonjë vlerësim të rrezikut për të përcaktuar se cilat rreziqe mund të jenë për ankuesen dhe familjen e saj dhe cilat masa shtesë të kujdesit dhe mbrojtjes, nëse ka, mund të jenë të garantuara. Në

vend të kësaj, Misioni e informoi ankuesen se ajo nuk do të kishte të drejtë për ndonjë mbështetje nga Misioni përveç asistencës në udhëtimin e saj. As sa duket, Misioni nuk i pyeti autoritetet serbe nëse ishte kryer ndonjë vlerësim i tillë i rrezikut ose, nëse kishte, cilat ishin konkluzionet e tij. Kjo sugjeron që Misioni nuk ka ushtruar nivelin e kujdesit që do të ishte i përshtatshëm në ato rrethana. Fakti që Misioni do të kishte vetëm përgjegjësi plotësuese ndaj atyre të autoriteteve vendore nuk sugjeron në asnjë mënyrë që detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut ishin shfuqizuar prej autoriteteve të Serbisë.

77. Paneli tani do t'i kthehet vlerësimit të shkeljeve të pretenduara të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Siç përshkruhet më lart, Paneli shpreh keqardhje që nuk mori shumë informacion dhe prova që kishte kërkuar nga secila palë. Prandaj, Paneli do të duhet të bëjë përcaktimin në bazë të informacionit në dispozicion të tij dhe të nxjerrë përfundimet e nevojshme nga dështimi i Misionit për të siguruar informacionin përkatës kur është e përshtatshme.

Shkeljet e pretenduara të nenit 3

78. Neni 3 i Konventës, për mbrojtjen nga tortura ose trajtimi çnjerëzor ose poshtëruar ose ndëshkim, kërkon që keqtrajtimi të arrijë një nivel minimal të ashpërsisë nëse do të bëhet brenda nenit 3 (shih p.sh. *Krasniqi kundër EULEX-it*, 2013- 02, 20 gusht 2013, paragrafi 11; *Kudla kundër Polonisë* nr. 30210/96, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 26 tetorit 2000, par. 91). Vuajtjet duhet të "tejkalojnë elementin e pashmangshëm të vuajtjeve" që rezultojnë nga një "formë e caktuar e trajtimit legjitim të dënimit" (shih *Kudla kundër Polonisë*, par. 92). Një vlerësim nëse ky prag është përmbushur mund të marrë parasysh disa faktorë. Gjykata ka deklaruar se "varet nga të gjitha rrethanat e rastit, të tilla si natyra dhe konteksti i trajtimit, mënyra dhe mënyra e ekzekutimit të tij, kohëzgjatja e tij, efektet e tij fizike dhe mendore dhe në disa rastet, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës "(shih *Kudla kundër Polonisë* par. 91). Gjykata gjithashtu e ka konsideruar të rëndësishme të merret parasysh nëse viktimi gjithashtu i përket një kategorie të personave që janë "të ndijshëm" në një farë aspekti (shih p.sh. *Khlaifia dhe të tjerët kundër Italisë*, Aplikacioni nr. 16483/12, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 15 dhjetor 2016, par. 194).
79. Paneli thekson përsëri që ankuesja është vetë viktimë e incidentit që ishte subjekt i procedurave penale në Serbi. Si e tillë, ajo do të kishte qenë veçanërisht në pozicion të cenueshëm, një fakt i njohur për Misionin në kohën e duhur. Ajo humbi një të afërm të ngushtë gjatë ngjarjeve dhe që prej asaj kohe iu kërkuar disa herë të siguronte dëshminë e saj të dëshmitarit rreth atyre ngjarjeve. Procedimet penale kanë të bëjnë me krime të pretenduara të llojit më të rëndë sipas ligjit ndërkombëtar dhe zhvillohen në kontekstin e përgjithshëm pas konfliktit në të cilin rreziku i frikësimit të dëshmitarëve dhe në të vërtetë ngjarja e tij, është e njohur. Një dëshmi e tillë mund të jetë në vetvete mjaft traumatike për viktimat. Një dështim për t'iu garantuar atyre një mjedis të sigurt për të dhënë provat e tyre mund të rrisë më tej traumën dhe stresin e shkaktuar nga një dëshmi e tillë.
80. Paneli gjithashtu vëren se Misioni nuk duket se ka ndërmarrë hapa pas kthimit të ankueses për të konstatuar seriozitetin e rreziqeve që ajo ka pësuar. Kjo do të kishte krijuar një ndjenjë të pafuqisë dhe cenueshmërisë që mund të kishte kontribuar në përkeqësimin e traumës së ankueses dhe rritjen e frikës së saj. Pasi kishte marrë përsipër të shërbente si kujdestar i saj për qëllimin e dëshmisë së saj, Misioni atëherë ishte i detyruar të siguronte që të mos dilnin pasoja të dëmshme nga kjo përfshirje. Misioni nuk duket se ka ndërmarrë ndonjë hap domethënës për të hulumtuar tek ankuesja.
81. Ankuesja ka ofruar dëshmi mjekësore të një diagnoze të sindromës së stresit pas traumatik dhe ajo gjithashtu ka përshkruar stresin domethënës që ka përjetuar gjatë

qëndrimit në Serbi, përfshirë në gjykatë, si dhe pasojat në shëndetin e saj pas kësaj. Panelit i kujtohet gjithashtu deklarata e ankueses në dokumentin e lartpërmendur konfidencial. Paneli nuk është në gjendje të përcaktojë shkallën në të cilën këto janë pasoja të drejtpërdrejta të veprimeve të Misionit. Megjithatë është e qartë se dështimi i Misionit për të siguruar një mjedis të sigurt për të dhënë dëshmitë e saj në Serbi dhe për të vepruar me zell përderisa ishte në Kosovë do të kishte qenë e tillë që të përkeqësonte çfarëdo traume që të mund të ketë ekzistuar më herët.

82. Kur vlerëson kontributin e Misionit në vuajtjet e ankueses, Paneli gjithashtu ka dhënë arsyen për faktin se Misioni ka refuzuar ose dështuar të sigurojë të gjithë informacionin e kërkuar. Kjo e ka parandaluar Panelin të përcaktojë thellësinë dhe shkallën reale të përfshirjes dhe përgjegjësive të Misionit ndërsa ankuesja ishte në Serbi. Si rezultat, Misioni gjithashtu nuk arriti të kundërshtonte *prima facie* rrëfimin e ankueses se ajo ishte viktimë e sulmeve serioze ndaj integritetit dhe mirëqenies së saj mendore.
83. Megjithatë Paneli thekson që ankuesja nuk ka arritur të sigurojë prova vërtetuese të kërcënimeve të pretenduara që ajo thotë se i ka marrë gjatë qëndrimit në Kosovë dhe mosveprimit të pretenduar të Misionit kur pretendohet se raportoi ato kërcënime në Mision. Paneli nuk ka dyshim se ankuesja ndjehet e kërcënuar. Sidoqoftë nuk është në gjendje të konstatojë natyrën dhe seriozitetin e tyre në mungesë të informacionit shtesë. Paneli vëren në lidhje me këtë se Misioni mund të kishte bërë hetime në atë kohë në lidhje me këto fakte dhe duhej ta kishte bërë atë me ushtrim të zellshëm të përgjegjësive të tij ndaj viktimës. Fakti që nuk arriti ta bëjë këtë do të ndikojë në vlerësimin e përgjithshëm të Panelit për peshën e çështjes në fjalë.
84. Sa i përket ngjarjeve në Serbi, Paneli, pasi ka shqyrtuar procesverbalin e gjykatës, pranon argumentin e Misionit se kërcënimet që ankuesja ka pretenduar se kanë ndodhur në sallën e gjykatës mund të lidhen me deklaratat dhe përkujtimet nga gjyqtari në lidhje me detyrimin për të folur të vërtetën. Megjithatë, Paneli thekson se ankuesja pretendon se ishte kërcënuar edhe jashtë sallës së gjykatës, por gjithashtu se asnjë provë nuk është siguruar për të mbështetur ato kërcënime të pretenduara.
85. Zbatimi i arsyetimit të gjykatës në lëndën *Kudla kundër Polonisë*, të qenit dëshmitar nuk do të çonte vetvetiu në një konstatim se vuajtja e dëshmitarit plotëson nivelin e ashpërsisë së kërkuar nga neni 3. Do të duhet të ketë një element shtesë të vuajtjes që i atribuohet Misionit përmes dështimit të tij për të mbrojtur ankuesin nga kërcënimet. Gjatë vlerësimit nëse dëmi i shkaktuar ndaj ankueses e plotëson prapësinë e kërkuar nga neni 3, Paneli ka marrë parasysh konsideratat dhe rrethanat e mëposhtme:
 - i. Trauma dhe frika e viktimës është reale dhe e vërtetë;
 - ii. Cenueshmëria e ankueses si dëshmitare dhe viktimë e krimeve të rënda;
 - iii. Frika dhe shqetësimi - i njohur për Misionin – që ajo ndjeu se duhej të dëshmonte për ato krime dhe, për më tepër, ta bënte këtë në Serbi;
 - iv. Mungesa e qartësisë dhe transparencës në lidhje me shpërndarjen e përgjegjësive për sigurinë dhe mirëqenien e ankueses përderisa ishte në Serbi;
 - v. Dështimi i Misionit për të kryer ndonjë vlerësim të rrezikut ose/dhe për të siguruar se do të ishte kryer nga autoritetet vendore;
 - vi. Dështimi i Misionit për të hetuar me zell (a) pretendimet e kërcënimeve në Serbi dhe (b) pretendimet e kërcënimeve në Kosovë;
 - vii. Dështimi i Misionit për t'u angazhuar plotësisht në lidhje me shqetësimet e ankueses dhe përkundrazi duke e lënë atë të kërkonte mjete juridike dhe mbrojtje vetë.

86. Bazuar në çfarë u përmend më sipër Paneli konstaton që rrethanat plotësojnë pragun e duhur të seriozitetit të kërkuar sipas Nenit 3 të Konventës. Sidoqoftë, Misioni nuk është përgjegjës për gjithçka që çoi në shkaktimin e dëmit të tillë tek ankuesja. Në veçanti, Misioni nuk është përgjegjës për cenueshmërinë e mëparshme të ankueses si dëshmitare dhe viktimë e veprave të rënda penale. As Misioni nuk ishte ekskluzivisht ose madje kryesisht përgjegjës për atë që ndodhi në Serbi. Prandaj, Misioni është përgjegjës vetëm për atë që mund të duket si një kontribut i vogël në dëmin dhe dëmtimin e shkaktuar ndaj të drejtave të ankuesit sipas nenit 3. Megjithatë ky kontribut është i natyrës serioze pasi i atribuohet misionit për sundimin e ligjit, përgjegjësia e të cilit ishte për të siguruar dhe mbrojtur ato të drejta. Ankuesja i besoi Misionit mbi atë bazë dhe e vuri veten në një situatë që duhej të varej nga kujdesi dhe zelli i Misionit. Ky besim nuk u shpërblye plotësisht.
87. Për ato arsye, Paneli konstaton se Misioni kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas Nenit 3 të Konventës.

Shkelja e pretenduar e nenit 8

88. Neni 8 i Konventës garanton të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare, vendbanimin dhe korrespondencën. Ankuesja pretendon se kërcënimet e pretenduara që rezultojnë nga dëshmia e saj në Serbi dhe dështimi nga Misioni për ta mbrojtur atë nga ato kërcënime, kishin pasur një ndikim të rëndësishëm negativ në shëndetin e saj.
89. Në këtë drejtim, Paneli vëren se e drejta për jetë private e garantuar sipas nenit 8 përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi, dhe imponon një detyrim pozitiv ndaj autoriteteve për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për situata të rrezikshme, veçanërisht kur autoritetet duhet kenë ditur për një rrezik të veçantë (shih p.sh. *X dhe Y kundër Holandës*, Aplikacioni nr. 8978/80, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 23 mars 1985, paragrafi 22; *Ebcin kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 19506/05, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 1 shkurt 2011, paragrafët 36-37).
90. Megjithatë Paneli thekson se Gjykata ka vërtetuar se duhet të ketë një lidhje midis autoriteteve dhe dëmtimit të pësuar dhe se që të lindë një detyrim për të vepruar, pretendimet e dhunës duhet të jenë specifike dhe të hollësishme (shih *Đurđević kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 52442/09, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 19 korrik 2011, paragrafët 117-118). Paneli i referohet përsëri faktit që ankuesja nuk ka arritur të ofrojë prova ose informacione të hollësishme në lidhje me kërcënimet e pretenduara ose hapat që ajo ndërmori për t'i sjellë ato kërcënime në vëmendjen e Misionit. Prandaj, Paneli konstaton se ka elemente të pamjaftueshme për të vërtetuar që Misioni nuk e mbrojt ankuesen nga dëmtimi i integritetit të saj fizik dhe psikologjik në shkelje të të drejtave të saja sipas nenit 8 të Konventës.
91. Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, është e qartë nga të dhënat e kësaj lënde se dëshmia e ankueses në Serbi mund të ketë krijuar një mjedis potencialisht të pasigurt për të dhe familjen e saj. Paneli është i shqetësuar se Misioni nuk ndërmori ndonjë vlerësim të rrezikut ose të vendoste masa mbrojtëse për ankuesen, duke pasur parasysh se ajo ishte nën përgjegjësinë e sigurisë së Misionit ndërsa ishte në Kosovë. Veprimet e Misionit dhe mosveprimi në lidhje me sigurinë në këtë rast nuk demonstrojnë nivelin e kujdesit dhe paralajmërimit që duhej të pritej nga misioni i sundimit të ligjit në një kontekst pas konfliktit në lidhje me një dëshmitar të cenueshëm në procedurat gjyqësore për krimet më të rënda sipas së drejtës ndërkombëtare. Paneli vëren se ndjekja e përgjithshme legjitime e Misionit për të kërkuar llogari për krime të tilla nuk mund të bëhet në dëm të aranzhimeve të duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve, domethënë atyre, dëshmitë e të cilëve janë thelbësore për arritjen e këtij objektiv.

92. Prandaj, Paneli do të ftojë Misionin të marrë në konsideratë mundësinë e komunikimit me homologët e tij vendorë për të përcaktuar se cilat masa duhet të merren për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e ankuesit.

PËR KËTO ARSYE PANELI NË SHUMICË

GJEN që Misioni ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas nenit 3 të Konventës në një masë të kufizuar të përshkruar më sipër;

KONSTATON se Misioni nuk ka shkelur të drejtat e ankueses sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

FTON MISIONIN QË

- i. Të pranoj që veprimi i tij ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankueses; dhe
- ii. Të kontakton ankuesen dhe autoritetet vendore për të vërtetuar nevojën për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankueses në Serbi.

KËRKON NGA MISIONI që t'ia shpërndajë këtë vendim zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij.

PANELI KËRKON NGA MISIONI të raportojë mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe t'u përgjigjet pyetjeve të tij sa më herët dhe jo më vonë se më 28 shkurt 2021.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare



Anna AUTIO
Anëtare